

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje uniforma”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Veshje
profesionale**

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,415,658 (katër milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Do të plotesohen me plotesimin e kapacitetit të përgjithshëm.

2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 2/c dhe pika 3, neni 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Furnizime te meparshme te ngjashme te realizuara gjate tre (3) viteve te fundit ne nje vlere jo me te vogel se 20% e fondit limit te kontrates objekt prokurimi.

Keto furnizime te ngjashme duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

- a) Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me institucione shtetore, operatori ekonomik duhet te paraqese:
 - Kontraten e lidhur si dhe vertetimin e leshuar nga institucioni shtetor per realizimin e furnizimeve dhe/ose
 - Faturat tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuar.

Dhe paraqitja e njerit prej dokumenteve konsiderohet i mjaftueshem per plotesimin e ketij kriteri.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Duke qënë se vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Per kete arsye eshte kerkuar nje ose disa furnizime të ngjashme në vlerën sa 20% e vleres se kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej min. 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Çertifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standart ISO më e avancuar, ku të jetë i përcaktuar objekti i prokurimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare kreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

3. Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Çertifikatë ISO 22301:2019, të standartit ndërkombëtar i Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe /ose të njëvlefshme, ose standart ISO më e avancuar, ku të jetë i përcaktuar objekti i prokurimit. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare kreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

4. Operatori ekonomik ofertues, në ditën dhe orën e caktuar përhapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe rekreacionit, Njesia e Prokurimit Publik, me adresë: Rruga "Xhemzi Delli" Godina nr.20, Tirane, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputheshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme. Mos paraqitja e mostrës sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 6 gërma "b" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat.....

5. Certifikatë OEKO-TEX

Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX për tekstilet, Standarti 100, klasi II (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, çertifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrësi duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të menaxhimit të mjedisit. Sistemi i menaxhimit të mjedisit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

6. Për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve sipas nr rendor: 1;4;5;11;17.

Të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare në fuqi. (Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 6 gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi skedë teknike sipas standarteve në specifikimet teknike nga firma prodhuese,per artikujt nr rendor 1-18 sipas sasise dhe grafikut te levrimet te shtojces 6 ne DT, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 6 gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- b) fotografitë apo katalogët teknikë

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për skualifikim.